



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr. 63, datë 14. 11. 2012

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI PARIMET BAZË TË DREJTIMIT TË BANKAVE DHE DEGËVE TË
BANKAVE TË HUAJA DHE KRITERET PËR MIRATIMIN E
ADMINISTRATORËVE TË TYRE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 24, pika 1, shkronja “c” dhe “ë” dhe pika 2, shkronja “b”; të nenit 40 shkronja “c” dhe të nenit 42 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

V E N D O S I:

1. Të miratojë rregulloren “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, rregullorja “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 40, datë 27.05.2009, shfuqizohet.

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

RREGULLORE

“ MBI PARIMET BAZË TË DREJTIMIT TË BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA DHE KRITERET PËR MIRATIMIN E ADMINISTRATORËVE TË TYRE”

(Miratuar me vendimin nr. 63 datë 14.11.2012 dhe ndryshuar me vendimin nr. 73 datë 6.12.2017 dhe me vendimin nr. 21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.)

KREU I Të përgjithshme

Neni 1 Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është:

- a. përcaktimi i parimeve dhe rregullave bazë për një drejtim të përgjegjshëm dhe efektiv të bankave dhe degëve të bankave të huaja;
- b. përcaktimi i kërkesave për një sistem efektiv të administrimit të rrezikut përfshirë edhe rrezikun e përputhshmërisë;
- c. përcaktimi i kërkesave minimale për hartimin, zbatimin dhe publikimin e politikës dhe të skemës së shpërblimit;
- d. përcaktimi i kriterëve që duhet të përmbushin administratorët e bankave dhe degëve të bankave të huaja, dhe i dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e tyre nga Banka e Shqipërisë; si dhe
- e. përcaktimi i kriterëve për lidhjen e marrëveshjeve me të tretët për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive për administrimin dhe drejtimin e bankës.

Neni 2 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë (këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhen “banka”).

Neni 3 Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 24, pika 1, shkronja “c” dhe “ë”, dhe pika 2, shkronja “b”;

nenit 40 shkronja “c” dhe nenit 42 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm, kanë këtë kuptim:
 - a) “plani për vazhdimësinë e aktivitetit të bankës” – është tërësia e masave të hartuara nga banka ose dega e bankës së huaj për të siguruar, sipas skenarëve në rastin e situatave të ndryshme të krizave, vazhdimësinë e aktivitetit kryesor të bankës, pavarësisht mosfunksionimit të shërbimeve të ofruara nga të tretët;
 - b) “rreziku i përputhshmërisë” – është mundësia që banka të pësojë humbje financiare ose të humbasë reputacionin si rezultat i moszbatimit, i shkeljeve, apo i mos përputhshmërisë me ligjet, rregullat, rregulloret, praktikat bankare, politikat dhe procedurat e brendshme, si dhe standardet e etikës së biznesit;
 - c) ¹“oreksi/toleranca ndaj rrezikut” - është niveli i agreguar dhe llojet e rrezikut që banka është e gatshme/në gjendje të ndërmarrë, brenda kapacitetit të rrezikut, për arritjen e objektivave strategjike të veprimtarisë dhe planit të biznesit të saj;
 - d) “drejtues joekzekutiv” – është anëtari i Këshillit Drejtues, i cili nuk është pjesë e drejtimit ekzekutiv të bankës;
 - e) ²“kapaciteti i rrezikut” - është niveli maksimal i rrezikut që banka mund të ndërmarrë, duke konsideruar mbështetjen tek kapitali, likuiditeti, kapaciteti huamarrës dhe kufijtë rregullatorë;
 - f) ³ “banka me rëndësi sistemike” janë bankat e licencuara dhe që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara si të tilla, sipas vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë;
 - g) ⁴ “kuadri i oreksit/tolerancës ndaj rrezikut” nënkupton qasjen e përgjithshme, përfshirë politikat, proceset, kontrollet dhe sistemet, përmes të cilëve është vendosur, komunikuar, dhe monitoruar oreksi/toleranca ndaj rrezikut. Ky kuadër përfshin, por jo vetëm, një deklaratë të oreksit/tolerancës ndaj rrezikut, kufijtë e rrezikut dhe një

¹ Ndryshuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

² Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³ Shtuar me vendimin nr. 21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴ Shtuar me vendimin nr. 21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

përshkrim të roleve dhe përgjegjësive të personave që mbikëqyrin zbatimin dhe monitorimin e tij (kuadrit). Kuadri merr parasysh rreziqet e rëndësishme (materiale) ndaj të cilëve ekspozohet banka, si dhe rrezikun reputacional të saj”;

- h) ⁵“deklarata e oreksit/tolerancës ndaj rrezikut” është artikulimi në formë të shkruar, i nivelit agregat dhe i llojeve të rrezikut, që një bankë është e gatshme të pranojë ose të shmangë, në mënyrë që të arrijë objektivat e saj të biznesit. Kjo përfshin deklarata cilësore dhe masa sasiore, të shprehura në lidhje me të ardhurat, kapitalin, madhësinë e rrezikut, likuiditetin dhe masat e tjera përkatëse sipas rastit, si dhe adreson vështirësitë për të përcaktuar nga ana sasiore rreziqe të tillë si rreziku i reputacionit dhe sjelljes, rreziku i pastrimit të parave dhe praktikat joetike, etj;
- i) ⁶“kufijtë e rrezikut” janë masat sasiore, të bazuara në supozimet e ardhshme, që shpërndajnë deklaratën agregate/e përgjithshme të oreksit/tolerancës ndaj rrezikut të bankës (p.sh. masën e humbjes ose ngjarjeve negative) ndaj linjave të biznesit, personave juridikë të rëndësishëm (pjesë e grupit bankar/financiar), kategorive të veçanta të rrezikut, përqendrimit dhe sipas nevojës, niveleve të tjera;
- j) ⁷ “profili i rrezikut” është vlerësimi, në një moment të caktuar, i ekspozimeve bruto dhe, sipas rastit, i ekspozimeve neto të bankës ndaj rrezikut (pasi janë marrë në konsideratë lehtësimet), të grumbulluara brenda dhe përgjatë secilës kategori të rrezikut, në bazë të supozimeve në perspektivë (*forward looking*).“

KREU II

Parimet dhe rregullat bazë të drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv

Neni 5

Organet drejtuese dhe kultura e përgjithshme e drejtimit

1. Këshilli drejtues dhe drejtoria, në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive që lidhen me drejtimin dhe kontrollin e bankës, njohin në mënyrë të plotë dhe të qartë profilin e rrezikut të bankës, duke përcaktuar/miratur paraprakisht ndërmarrjen dhe ⁸ oreksin/tolerancën ndaj tij (rrezikut), ndjekjen në vazhdimësi të tij në përputhshmëri me këto të fundit, duke siguruar që nivelet e kapitalit të mbulojnë mjaftueshëm këtë rrezik.
2. Këshilli drejtues dhe drejtoria, nëpërmjet mënyrës së drejtimit, nxisin (stimulojnë) një kulturë të përshtatshme drejtimi, e cila ka për përparësi ndershmërinë dhe krijimin e marrëdhënieve korrekte ndërmjet nëpunësve, të bazuar në standarde të larta profesionale dhe vlera të larta etike.

⁵ Shtuar me vendimin nr. 21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁶ Shtuar me vendimin nr. 21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁷ Shtuar me vendimin nr. 21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁸ Ndryshuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

3. Këshilli drejtues në bashkëpunim me drejtorinë, marrin masa për arritjen e standardeve të larta etike dhe profesionale në drejtimin e bankës.
4. Banka siguron që, në përputhje me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj, njohuritë, eksperiencat dhe kualifikimet e anëtarëve të këshillit drejtues të ndërthuren njëkohësisht me njëra tjetrën, në mënyrë që të krijohet një kualifikim kolektiv, i përshtatshëm i këshillit drejtues.
5. ⁹Banka harton një politikë të veçantë për emërimin e anëtarëve të këshillit drejtues, duke specifikuar kërkesat mbi diversifikimin e përbërjes së këshillit drejtues, në funksion të sigurimit të njohurive, kualifikimeve dhe eksperiencave kolektive të tij (këshillit drejtues), në fusha të ndryshme të drejtimit dhe të kontrollit.

Neni 6 Këshilli drejtues

1. Këshilli drejtues, në funksion të drejtimit të bankës në përputhje me objektivat, strategjitë dhe politikat e miratuara, si dhe në interesin më të mirë të saj, shqyrton dhe vlerëson:
 - a. zhvillimin dhe mbajtjen e një niveli të mjaftueshëm të ekspertizës profesionale në përputhje me rritjen dhe kompleksitetin e veprimtarisë së bankës;
 - b. sigurinë dhe qëndrueshmërinë financiare të bankës;
 - c. njohjen e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
 - d. parandalimin dhe shmangien e konflikteve të mundshme të interesit në veprimtarinë dhe vendimmarrjen e bankës; si dhe
 - e. mbrojtjen e interesave të klientëve, investitorëve dhe të publikut në përgjithësi.
2. Këshilli drejtues drejtohet nga kryetari, i cili është përgjegjës për funksionimin efektiv të tij (këshillit), duke përfshirë edhe mbajtjen në vazhdimësi të një marrëdhënieje besimi me anëtarët e tij, me qëllim që të sigurojë:
 - a. marrjen e vendimeve mbi një bazë të shëndoshë dhe të mirinformuar;
 - b. inkurajimin dhe promovimin e diskutimeve kritike; dhe
 - c. shprehjen e pikëpamjeve kundërshtuese si dhe zhvillimin e diskutimeve në kuadër të procesit të vendimmarrjes.

Neni 7 Drejtoria

1. Drejtoria organizon dhe drejton në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e bankës.

⁹ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- 2 Drejtoria përcakton dhe mund të delegojë detyrat tek personeli, si dhe mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësive të deleguara, në përputhje me politikat dhe procedurat e miratuara.
- 3 Drejtoria ndërmerr masat e nevojshme për të monitoruar dhe administruar të gjitha rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar banka, në përputhje me strategjitë e miratuara.
- 4 Drejtoria zbaton politikat dhe strategjitë e miratuara, si dhe siguron që proceset e administrimit të rrezikut të jenë në përshtatje të vazhdueshme me profilin e rrezikut të bankës dhe planin e biznesit të miratuar.

Neni 8

Efektiviteti i punës së këshillit drejtues dhe bashkëpunimi i organeve drejtuese

1. Këshilli drejtues, informohet rregullisht nga drejtoria, në mënyrë të plotë dhe në kohën e duhur, për çështjet e rëndësishme që lidhen me operacionet e bankës, në veçanti, për administrimin e rrezikut, zbatimin e strategjive dhe politikave, si dhe për çdo shmangie nga objektivat e miratuara.
2. Këshilli drejtues, në bashkëpunim/konsultim me drejtorinë, merr vendime në interesin më të mirë të bankës, të cilat ndikojnë në drejtimin dhe kontrollin e kujdesshëm të saj, lidhur me çështjet e mëposhtme:
 - a. objektivat e veprimtarisë;
 - b. politikat dhe udhëzimet për arritjen e këtyre objektivave;
 - c. strategjitë për ndërmarrjen e rreziqeve dhe administrimin e tyre; si dhe
 - d. analizat lidhur me profilin e rrezikut.
3. Këshilli drejtues mbështetur në raportet, analizat dhe informacionet e marra nga drejtoria, rishikon rregullisht politikat e miratuara dhe vlerëson, në vazhdimësi, përshtatshmërinë e tyre me zhvillimet e bankës dhe të tregut.
4. Këshilli drejtues dhe drejtoria përdorin në mënyrë efektive informacionet dhe konkluzionet e marra nga njësia ose sistemi i kontrollit të brendshëm, eksperti kontabël i autorizuar dhe struktura të tjera të kontrollit të bankës.

Neni 9

Autonomia e administratorëve

1. Administratorët, brenda kompetencave të përcaktuara nga ligji, aktet nënligjore dhe organet drejtuese, vlerësojnë dhe marrin në mënyrë të pavarur dhe objektive, vendime lidhur me veprimtarinë e bankës.
2. Në zbatim të përcaktimeve të paragrafit 1 të këtij neni, administratori merr në konsideratë të gjithë informacionin e vlefshëm, të mjaftueshëm dhe të plotë, si dhe faktorë të tjerë përkatës që mund të ndikojnë në këto vendime.

Neni 10

Komitetet e krijuara nga këshilli drejtues

1. Këshilli drejtues, në përputhje me natyrën, madhësinë, kompleksitetin e veprimtarisë dhe profilin e rrezikut të bankës, mund të krijojë komitete të specializuara në nivel këshilli drejtues, të tilla si komiteti i rrezikut/qeve, komiteti i shpërblimeve, komiteti i emërimeve etj., të cilat këshillojnë/asistojnë këshillin për çështje të veçanta.
2. Krijimi i komiteteve bëhet me vendim të këshillit drejtues, në të cilin përcaktohet në mënyrë të qartë, qëllimi i krijimit, mandati, përbërja dhe rregullat e funksionimit të komitetit.
3. Çdo komitet i krijuar nga këshilli drejtues sipas këtij neni përbëhet nga një kryetar dhe të paktën dy anëtarë.
4. Bankat publikojnë në raportet e tyre vjetore, emrat e komiteteve të krijuara nën varësinë e këshillit drejtues, mandatet dhe përbërjen e tyre.

KREU III

Sistemi i administrimit të rrezikut, funksioni i përputhshmërisë dhe politika e shpërblimit

Neni 11

Kërkesa të përgjithshme

1. Bankat krijojnë dhe zhvillojnë sistemin për administrimin e rrezikut, të përshtatshëm me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre.
2. Sistemi i administrimit të rreziqeve është tërësia e politikave, procedurave, rregullave dhe strukturave të bankës, që shërbejnë për administrimin e rrezikut.
3. “Sistemi i administrimit të rrezikut” përfshin:
 - a) procesin e identifikimit, të matjes, të monitorimit, të kontrollit dhe të raportimit, të të gjitha rreziqeve brenda një banke, në të gjithë aktivitetin e saj (për të gjithë bilancin, portofolin dhe linjat e biznesit);
 - b) përcaktimin e funksioneve të strukturave të administrimit të rrezikut, të cilat sigurojnë:
 - i) Identifikimin e të gjitha rreziqeve në bankë;
 - ii) vlerësimin e rreziqeve dhe matjen e ekspozimit ndaj tyre;
 - iii) monitorimin e ekspozimit të rrezikut dhe përcaktimin e nevojave për kapital në mënyrë të vazhdueshme;
 - iv) monitorimin dhe vlerësimin e vendimeve për pranimin e rreziqeve të caktuara, masat për zbutjen e rrezikut dhe nëse vendimet janë në

përputhje me vendimet e këshillit drejtues për politikat e rrezikut dhe tolerancës së rreziku;

- v) raportimin, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pavarur, në këshillin drejtues si dhe tek drejtuesit ekzekutivë, të të gjitha çështjeve të përcaktuara më lart.

Neni 12

Politikat, rregullat dhe procedurat e brendshme të bankës

1. Bankat, në hartimin e politikave për administrimin e rrezikut, sigurojnë që këto politika të jenë të zbatueshme, të kuptueshme dhe të mirëpërcaktuara për çdo njësi/strukturë të bankës.
2. Politikat për administrimin e rrezikut duhet të përfshijnë minimalisht elementët e mëposhtëm:
 - a) strukturën organizative dhe objektin e funksionit të administrimit të rrezikut;
 - b) metodën e matjes së rrezikut;
 - c) detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës/ave të administrimit të rrezikut;
 - d) strukturën dhe frekuencën e mbledhjeve të komitetit të administrimit të rrezikut;
 - e) metodën e vendosjes/përcaktimit të kufijve/normave të rrezikut dhe procedurat në rastet e shkeljes së këtyre kufijve/normave;
 - f) mënyrën e informimit dhe procedurat e raportimit;
 - g) miratimet dhe/ose konfirmimet, që duhet të jepen në rrethana të veçanta.
3. Bankat sigurojnë që politikat e administrimit të rrezikut të përshtaten në mënyrën e duhur me strukturën e bankës, duke u kujdesur në veçanti që:
 - a) sistemet e administrimit të rrezikut, si në baza individuale dhe të konsoliduara, të jenë të kuptueshme nga drejtimi i lartë dhe personeli i bankës;
 - b) strategjitë e administrimit të rrezikut marrin në konsideratë balancën/raportin midis rreziqeve të ndryshme dhe kapitalit të bankës;
 - c) rreziqet në veprimtarinë kryesore/bazë të bankës janë të diversifikuara; dhe
 - d) janë ndërmarrë masat e nevojshme për monitorimin e efekteve negative të rreziqeve sistemike, që rrjedhin nga sistemet e pagesave (të cilat mund të shkaktohen nga banka të veçanta që operojnë në treg) dhe ndikojnë në stabilitetin e sistemit.
4. Bankat, në funksion të zbatimit të politikave për administrimin e rrezikut, hartojnë rregulla dhe procedura të brendshme.

Neni 13

Struktura e administrimit të rrezikut

1. Bankat, në varësi të veprimtarisë dhe profilit të rrezikut, krijojnë një strukturë/njësi të veçantë për kryerjen e funksionit të administrimit të rreziqeve si dhe emërojnë një drejtues ekzekutiv për administrimin e rrezikut.¹⁰ Kjo strukturë/njësi ka autoritetin, reputacionin, njohuritë dhe burimet e mjaftueshme, të cilat sigurojnë zbatimin e politikave të rrezikut dhe të kuadrit të administrimit të rreziqeve, si dhe të proceseve efektive të administrimit të rrezikut.

1/1. ¹¹Struktura/njësia e administrimit të rrezikut është e pavarur nga linjat e biznesit dhe nga njësitë e brendshme që kontrollojnë, si dhe ka linjë të veçantë raportimi dhe varësie prej tyre. Në çdo rast, kjo strukturë bashkëvepron me linjat e biznesit/njësitë e brendshme, me qëllim arritjen e objektivave. Ndërveprimi midis funksioneve operacionale dhe strukturës/njesisë së administrimit të rrezikut duhet të ndihmojë në arritjen e objektivave të të gjithë stafit të bankës që është përgjegjës për administrimin e rreziqeve.

2. Bankat, në varësi të natyrës, madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë së tyre, ndajnë rolin e drejtuesit ekzekutiv të administrimit të rrezikut nga ai i drejtuesve që mbulojnë funksione të tjera në bankë.

3. Punonjësit e strukturës/njesisë së administrimit të rrezikut duhet të kenë eksperiencën e mjaftueshme dhe kualifikimet e nevojshme për produktet e tregut dhe teknikat e matjes së rreziqeve për të gjitha linjat e biznesit të bankës dhe të gjitha rreziqet, me të cilat përballet banka gjatë aktivitetit të saj,¹² si dhe të kryejnë trajnime të rregullta.

4. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut kryen analiza sasiore dhe cilësore të elementëve të rrezikut, me qëllim identifikimin e ekspozimit të rrezikut potencial, duke dhënë edhe konsideratat e përshtatshme për bankën,¹³ si dhe jep rekomandimet e nevojshme për përmirësimet e kuadrit të administrimit të rrezikut dhe për masat korrigjuese për ndreqjen e shkeljeve në politikat, procedurat dhe kufizimet e rrezikut.

5. Roli i strukturës/njesisë së administrimit të rrezikut duhet të jetë i qartë dhe transparent në drejtim të përgjegjësisë të personelit në lidhje me rreziqet.

6. Bankat dokumentojnë bashkëveprimin periodik midis strukturës/njesisë së administrimit të rrezikut dhe këshillit drejtues.

7. ¹⁴Struktura/njësia e administrimit të rrezikut përfshihet paraprakisht në hartimin e strategjisë së rrezikut dhe siguron që banka ka krijuar procese efektive të administrimit të rrezikut. Kjo strukturë/njësi i siguron këshillit drejtues të gjithë informacionin e nevojshëm për çështjet që lidhen me rrezikun, me qëllim përcaktimin e nivelit të oreksit/tolerancës ndaj rrezikut nga këshilli.

¹⁰ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹¹ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹² Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹³ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁴ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

8. ¹⁵Struktura/njësia e administrimit të rrezikut vlerëson qëndrueshmërinë e strategjisë dhe oreksit/tolerancës ndaj rrezikut dhe siguron që oreksi/toleranca ndaj rrezikut të përshtatet në mënyrën e duhur me kufijtë specifikë të ekspozimeve ndaj rrezikut.
9. ¹⁶Struktura/njësia e administrimit të rrezikut vlerëson strategjitë e rrezikut të njësive të biznesit (duke konsideruar edhe objektivat e propozuar nga këto njësi), dhe ia paraqet këtë vlerësim këshillit drejtues, përpara se të marrë vendime mbi këto strategji. Objektivat e njësive të biznesit duhet të jenë të besueshëm dhe në përputhje me strategjinë e rrezikut të bankës.
10. ¹⁷Struktura/njësia e administrimit të rrezikut përfshihet në vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve të rëndësishme (materiale) dhe të transaksioneve jo të zakonshme mbi rrezikun e përgjithshëm të bankës dhe të grupit bankar/financiar, si dhe raporton gjetjet drejtpërdrejt tek këshilli drejtues, përpara se të merren vendimet mbi këto ndryshime apo transaksione.
11. ¹⁸Struktura/njësia e administrimit të rrezikut vlerëson ndikimin e rreziqeve të identifikuar, në aftësinë e bankës apo të grupit bankar/financiar për të administruar profilin e rrezikut, si dhe likuiditetin e bazën e qëndrueshme të kapitalit të tij, në rrethana normale dhe të pafavorshme.
12. ¹⁹Struktura/njësia e administrimit të rrezikut siguron që rreziqet identifikohen, vlerësohen, maten, monitorohen, administrohen, zbuten dhe raportohen nga dhe tek njësitë përkatëse të bankës.
13. ²⁰Struktura/njësia e administrimit të rrezikut siguron që të analizohen transaksionet me personat e lidhur, si dhe të identifikohen dhe vlerësohen në mënyrë të përshtatshme rreziqet që ato krijojnë për bankën.
14. ²¹Struktura/njësia e administrimit të rrezikut siguron që të gjithë rreziqet e identifikuar të mund të monitorohen në mënyrë efektive nga njësitë e biznesit.
15. ²²Struktura/njësia e administrimit të rrezikut monitoron rregullisht profilin ekzistues të rrezikut të bankës dhe e shqyrton atë në kuadër të objektivave strategjike të bankës dhe të oreksit/tolerancës ndaj rrezikut, duke informuar në mënyrë të plotë, gjithëpërfshirëse dhe të mjaftueshme këshillin drejtues.
16. ²³Struktura/njësia e administrimit të rrezikut vlerëson mënyrat e mundshme për të zbutur rreziqet, si dhe i propozon këshillit drejtues planin e veprimeve të përshtatshme për zbutjen e rrezikut.

¹⁵ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁶ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁷ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁸ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁹ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁰ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²¹ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²² Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²³ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁴Neni 13/1

Drejtuesi i strukturës/njesisë së administrimit të rrezikut

1. Drejtuesi i strukturës/njesisë së administrimit të rrezikut është përgjegjës për dhënien e informacionit të plotë dhe të kuptueshëm mbi rreziqet, si dhe për të këshilluar këshillin drejtues, me qëllim që këshilli të kuptojë profilin e përgjithshëm të rrezikut të bankës.
2. Drejtuesi i strukturës/njesisë së administrimit të rrezikut ka ekspertizën e duhur, pavarësinë e mendimit dhe eksperiencën e mjaftueshme për të diskutuar/sfiduar vendimet që ndikojnë në ekspozimin ndaj rrezikut të bankës.
3. Drejtuesi i strukturës/njesisë së administrimit të rrezikut argumenton dhe dokumenton, në çdo rast, qëndrimet e tij kundërshtuese mbi vendimet e propozuara për t'u marrë nga drejtoria. Nëse një bankë i jep drejtuesit të strukturës/njesisë së administrimit të rrezikut, të drejtën e vetos, për një vendimmarrje (si p.sh. miratimi i një ekspozimi kredie apo investimi, ose vendosja e një kufizimi), më poshtë vendimmarrjes në nivel këshilli drejtues, banka specifikon në aktet e saj të brendshme shtrirjen e kësaj të drejte dhe qëllimin, përshkallëzimin, apo procedurat e apelit të kësaj vendimmarrjeje dhe mënyrën sesi do të përfshihet këshilli drejtues.
4. Bankat, për vendimet për të cilët drejtuesi i strukturës/njesisë së administrimit të rrezikut ka shprehur një opinion negativ, përcaktojnë në procedurat e tyre të brendshme procese të përforcuara dhe të specifikuara qartë se si do të miratohen në vijim këto vendime. Këshilli drejtues komunikon në mënyrë të drejtpërdrejtë me drejtuesin e kësaj strukture/njësie mbi çështje me rëndësi të rrezikut, përfshirë edhe zhvillime që mund të mos jenë në përputhje me oreksin/tolerancën ndaj rrezikut dhe strategjinë e rrezikut të bankës.
5. Drejtuesi i strukturës/njesisë së administrimit të rrezikut raporton në mënyrë periodike në këshillin drejtues, në komitetin e rrezikut dhe tek drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i bankës.

Neni 14

Funksioni i përputhshmërisë

1. Bankat duhet të kenë një drejtues ekzekutiv, që kryen funksionin e identifikimit, koordinimit dhe të administrimit të rrezikut të përputhshmërisë së bankës.
- 1/1. ²⁵Struktura/njësia e përputhshmërisë është e pavarur nga linjat e biznesit dhe nga njësitë e brendshme që kontrollojnë dhe ka autoritetin, reputacionin dhe burimet e mjaftueshme.

²⁴ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁵ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

2. Përgjegjësia kryesore e strukturës/njesisë, që përmbush funksionin e përputhshmërisë së bankës është asistimi/ndihmesa i/e drejtuesve ekzekutivë të bankës, në administrimin efektiv të rrezikut të përputhshmërisë.
3. Struktura/njësia e përputhshmërisë këshillon drejtuesit ekzekutivë të bankës, lidhur me përputhshmërinë me ligjet, rregullat dhe standardet, duke e informuar atë në vazhdimësi, mbi zhvillimet në këtë fushë, si dhe në veçanti kryen/përmbush detyrat e mëposhtme:
 - a) edukimin dhe trajnimin e personelit për çështjet e përputhshmërisë, duke shërbyer dhe si pikë kontakti brenda bankës për çështje apo pyetje të personelit lidhur me përputhshmërinë;
 - b) hartimin e udhëzimeve të brendshme për zbatimin e ligjeve, të rregulloreve dhe të standardeve nëpërmjet politikave dhe procedurave apo dokumenteve të tjera si manualët e përputhshmërisë, kodet e brendshme të etikës dhe udhëzimet praktike;
 - c) ²⁶ verifikimin, në bashkëpunim të ngushtë me strukturën/njësinë e administrimit të rrezikut dhe njësinë ligjore apo struktura të tjera të bankës, që produktet dhe procedurat e reja janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
 - c/1) ²⁷ vlerësimin e ndikimit të mundshëm të çdo ndryshimi ligjor dhe rregullativ në veprimtarinë e bankës dhe në kuadrin e përputhshmërisë;
 - d) matjen e rrezikut të përputhshmërisë duke përdorur treguesit e performancës (të tillë si rritja e numrit të ankesave të klientëve, parregullsitë në pagesa etj.), me qëllim vlerësimin e këtij rreziku;
 - e) vlerësimin e përshtatshmërisë së procedurave dhe rregulloreve të përputhshmërisë, si dhe vlerësimin e mangësive të identifikuara duke mundësuar edhe propozime për amendime;
 - f) monitorimin, testimin dhe raportimin e rezultateve nga testimi i mjaftueshmërisë së përputhshmërisë, sipas procedurave të sistemit të brendshëm të administrimit të rrezikut, duke evidentuar edhe ndryshimet në profilin e rrezikut të përputhshmërisë, mbështetur në treguesit e performancës, shkeljeve dhe/ose mangësive të identifikuara dhe të masave korrigjuese të ndërmarra;
 - g) krijimin e një kulture inkurajuese dhe të përshtatshme për komunikimin/sinjalizimin nga ana e punonjësve të bankës, të mospërputhshmërisë me rregullat, procedurat, operacionet etj., duke siguruar njëkohësisht konfidencialitetin dhe mbrojtjen e këtyre të fundit (punonjësve).
4. Struktura/njësia e përputhshmërisë mund të kryejë dhe detyra të tjera të veçanta, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore të bankës (të tilla si ato të parandalimit të pastrimit të parave etj.), si dhe mban lidhje me Bankën e Shqipërisë dhe/ose autoritete të tjera të mbikëqyrjes së veprimtarisë financiare, ekspertin kontabël të autorizuar etj.
5. Struktura/njësia e përputhshmërisë kryen detyrat e përcaktuara në këtë rregullore dhe në aktet rregullative të bankës, mbështetur në një program

²⁶ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁷ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

pune, që përcakton aktivitetet e planifikuara, të tilla si zbatimi dhe rishikimi i politikave, procedurave të veçanta të rrezikut të përputhshmërisë, vlerësimet, testet e përputhshmërisë dhe edukimin e trajnimit të personelit për çështje të përputhshmërisë.

6. Programi i strukturës/njesisë së përputhshmërisë duhet të jetë i bazuar/fokusuar tek rreziku dhe duhet të rishikohet në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që të sigurohet që ky program mbulon të gjithë linjat e biznesit/veprimtarisë së bankës dhe siguron koordinimin midis funksioneve të administrimit të rrezikut.

Neni 15 **Politikat e shpërblimit**

1. Këshilli drejtues, në përputhje me strategjinë, objektivat afatgjatë të veprimtarisë së bankës dhe ecurinë e saj, përcakton qartë dhe miraton politikat e shpërblimit të bankës.
2. Këshilli drejtues përcakton skemat dhe masën e shpërblimit në përputhje dhe në funksion të profilit të rrezikut. Për këtë qëllim, këshilli drejtues mund të asistohet nga një komitet i krijuar prej tij (Komiteti i Shpërblimeve).
3. Këshilli drejtues siguron që anëtarët e komitetit të shpërblimeve të jenë drejtues joekzekutivë dhe të kenë njohuri mbi politikat e shpërblimeve, mbi stimujt që mund të jenë parashikuar në kontratën e punës dhe rreziqet që mund të lindin nga këto kontrata.
4. Komiteti i shpërblimeve punon ngushtësisht me komitetin e rrezikut për të vlerësuar treguesit, që mund të përdoren si stimuj për përcaktimin e shpërblimeve dhe siguron rishikimin mbi baza vjetore të shpërblimeve, bazuar në objektivat afatgjatë të bankës, strategjinë e rrezikut dhe performancën.
5. Këshilli drejtues synon që politikat e shpërblimit të nxisin administrimin efektiv të rrezikut dhe të mos inkurajojnë marrjen e rrezikut përtej²⁸oreksit/tolerancës ndaj rrezikut, të përcaktuar nga banka.
6. ²⁹Politikat e shpërblimit, hartohen për të gjithë personelin e bankës dhe mbulojnë të gjitha format dhe elementet e shpërblimit, duke përfshirë pagën, bonuset, përfitime të tjera financiare dhe materiale dhe përfitimet nga pjesëmarrjet në skemat e pensioneve vullnetare (nëse kanë), etj.:
 - a) Banka identifikon personat, aktiviteti i të cilëve ka një impakt material në profilin e rrezikut të bankës (personeli i identifikuar);
 - b) Në kategorinë “personel i identifikuar” do të përfshihen:

i. drejtuesit ekzekutivë të bankës;

²⁸ Ndryshuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁹ Ndryshuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- ii. punonjësit e njësisë së kontrollit të brendshëm;
- iii. punonjësit që ndërmarrin rrezik në detyrat që kryejnë (p.sh. tregtuesit e letrave me vlerë etj.);
- iv. të gjithë punonjësit, veprimtaria e të cilëve gjykohet se ka ndikim në profilin e rrezikut të bankës.

7. ³⁰Politikat e shpërblimit përmbajnë elementet e mëposhtëm:

- a) objektivat e performancës së bankës, sipas fushave të veprimtarisë dhe të biznesit, si dhe për punonjësit;
- b) metodat e matjes/vlerësimit të performancës, duke përfshirë dhe kriteret e vlerësimit të performancës;
- c) elementet e ndryshueshëm të shpërblimit, si dhe rregullat e ndryshimit të këtyre elementeve, përpara dhënies së shpërblimit (*ex-ante*) dhe pas dhënies së shpërblimit (*ex-post*).

8. ³¹Stafi, i cili ushtron funksionet e kontrollit, është i pavarur nga njësitë e biznesit që kontrollojnë dhe shpërblehen, bazuar në arritjen e objektivave që lidhen me funksionet e tyre, në mënyrë të pavarur nga performanca e fushave të biznesit që ato kontrollojnë.

9. ³²Politikat dhe praktikat e shpërblimit, janë të qarta, të mirëdokumentuara dhe transparente për stafin, për sa u përket elementeve përbërës (të ndryshueshëm dhe të pandryshueshëm) dhe kriteret e përfitimit të tyre. Politikat e shpërblimit për kategorinë personeli "i identifikuar", janë të mirëpërcaktuara për sa i përket elementit të ndryshueshëm.

10. Këshilli drejtues vendos shpërblimin mbi bazën e elementeve të pandryshueshëm dhe të ndryshueshëm. Raporti midis elementit të pandryshueshëm dhe atij të ndryshueshëm, në totalin e shpërblimit, ndryshon sipas kategorive të personelit të bankës.

11. ³³Elementi i pandryshueshëm (fiks) i shpërblimit përfaqëson pjesën më të lartë në totalin e shpërblimit, me qëllim që të lejojë funksionimin e politikave elastike/fleksibël për elementin e ndryshueshëm në shpërblim, duke përfshirë edhe mundësinë e mos pagimit të elementit të ndryshueshëm. Elementi i pandryshueshëm është i përhershëm, i paracaktuar i përvokueshëm, si dhe nuk ofron stimuj për të ndërmarrë rrezik dhe nuk varet nga performanca.

12. Elementi i ndryshueshëm përcaktohet në varësi të situatës financiare të bankës, performancës së përgjithshme të saj dhe performancës së njësive individuale të biznesit. Ky element mund të zbatohet për një kategori të caktuar të stafit, të identifikuar nga banka.

13. ³⁴Elementi i ndryshueshëm mund të jetë në disa forma (bonuse, aksione, etj.) dhe zvogëlohet në rastet kur banka ka performancë financiare

³⁰ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³¹ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³² Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³³ Ndryshuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁴ Ndryshuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

negative, ose hiqet në rastet kur ajo (banka) rezulton me humbje. Si element i ndryshueshem konsiderohen edhe disa nga pagesat apo angazhimet për pagesë për punonjësit, të përfshira në konceptin e "pagesës së shpërndarjes", sipas nenit 23 të rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit".

- 14.³⁵Elementi i ndryshueshem mund të paguhet menjëherë, ose i shtyrë në kohë (deferred). Elementi i ndryshueshem i shtyrë në kohë, nënkupton se një pjesë e shpërblimit të ndryshueshem, e cila mund të jetë në *cash* ose instrumente, i akordohet punonjësit, por pagesa kryhet përgjatë një periudhe disavjeçare ose në fund të kësaj periudhe.
- 15.³⁶Rregullimi i elementeve (të ndryshueshem) të shpërblimit përpara se të jepet shpërblimi (*ex-ante*), bazohet në treguesit e rrezikut dhe siguron që këto elemente (të ndryshueshem) janë në përputhje me rrezikun që ndërmerret dhe plotësojnë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:
 - a) janë të specifikuar qartë dhe me detaje, reflektojnë më së miri të gjithë rreziqet, si dhe kanë të përcaktuar nivelin e zbatimit të tyre (si: njësi biznesi, nënjësi organizative apo edhe në nivel individual);
 - b) janë të natyrës sasiore, të cilët përdoren në bankë për administrimin e rreziqeve;
 - c) janë të natyrës cilësore, të cilët përfaqësojnë edhe elemente rreziku dhe kontrolli, si për shembull shkelje të përputhshmërisë, thyerje të kufijve të rrezikut dhe tregues të kontrolleve të brendshëm (bazuar në gjetjet e kontrollit të brendshëm) ose metoda të ngjashme.
- 16.³⁷Rregullimi i elementeve (të ndryshueshem) të shpërblimit, pasi të jepet shpërblimi (*ex-post*), siguron që të gjithë anëtarët e stafit janë shpërblyer bazuar në një performancë të qëndrueshme për periudhën afatgjatë, si rezultat i vendimeve të marra në të kaluarën.
- 17.³⁸Banka, në rastet e zbatimit të rregullimit *ex-post* të elementit të ndryshueshem, ka kritere të mirëpërcaktuara, se si do të bëhet ky rregullim i elementit të ndryshueshem.
- 18.³⁹Totali i shpërblimeve (të ndryshueshme), të dhëna nga banka, nuk kufizon, aftësinë e bankës, për të mbajtur ose rekuperuar pozitën kapitalizuese të saj, në perspektivën afatgjatë. Bankat konsiderojnë këtë kërkesë, rezultatet nga procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit (PVBMK) dhe planifikimin disavjeçar të kapitalit, kur përcaktojnë shumën totale të shpërblimit (elementit të ndryshueshem), që jepet përgjatë një viti.

³⁵ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁶ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁷ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁸ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁹ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- 19.⁴⁰Këshilli drejtues, ose aty ku është e aplikueshme, komiteti i shpërblimeve, rishikon periodikisht politikat dhe praktikat e shpërblimit, me qëllim që të pasqyrojë në to ndryshimin e situatës financiare, në të cilën ndodhet banka dhe është përgjegjës për zbatimin e saj (politikës). Ky rishikim kryhet të paktën një herë në vit.
- 20.⁴¹Funksioni i kontrollit të brendshëm të bankës mbizotëruese (në rastin e grupit bankar/financiar) siguron një rishikim gjithëpërfshirës të përputhshmërisë së politikave të shpërblimit me rregulloren, politikat, procedurat dhe rregullat e brendshme të grupit.
- 21.⁴²Rishikimi i pavarur periodik i politikave të shpërblimit mund të realizohet pjesërisht ose tërësisht, edhe nga jashtë për bankat e vogla dhe më pak komplekse. Bankat më të mëdha dhe më komplekse kanë burime të mjaftueshme për të kryer rishikimin me stafin në dispozicion, ndërsa konsulentët e jashtëm, të kualifikuar dhe të pavarur, mund të plotësojnë dhe mbështesin bankën në përmbushjen e detyrave të tilla.
- 22.⁴³Bankat vlerësojnë nëse politikat e përgjithshme të shpërblimit, praktikat dhe proceset:
- a) zbatohen siç parashikohet në aktet e brendshme të bankës, duke u fokusuar në veçanti në respektimin e procedurave dhe rregullave të brendshme, që pagesat e shpërblimit janë të duhura dhe në linjë me strategjinë e biznesit, si dhe që profili i rrezikut, objektivat afatgjatë dhe objektiva të tjerë të bankës janë reflektuar në mënyrë të përshtatshme;
 - b) janë në përputhje me rregulloret, parimet dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare; dhe
 - c) zbatohen vazhdimisht në grup dhe nuk kufizojnë aftësinë e bankës për të marrë në konsideratë rrezikun, dhe për të përmbushur detyrimet e kapitalit dhe likuiditetit në linjë me pikën 28.1, shkronja “g” të udhëzuesit “Mbi drejtimin e brendshëm dhe efektiv të bankave”.
- 23.⁴⁴Funksionet e tjera të brendshme të bankave (p.sh. burimet njerëzore, ligjore dhe planifikimi strategjik, etj.), si dhe komitetet e tjera kryesore të këshillit drejtues (p.sh. komitetet e kontrollit, rrezikut/qeve dhe emërimeve), përfshihen nga afër në shqyrtimin e politikave të shpërblimit të bankës, në mënyrë që të sigurohet harmonizimi me strategjinë dhe kuadrin e administrimit të rrezikut të bankave.
- 24.⁴⁵ Këshilli drejtues ose komiteti i shpërblimit, në rastet kur rishikimet periodike evidentojnë që politikat e shpërblimit nuk funksionojnë sipas parashikimeve ose rekomandimeve të mëparshme, siguron propozimin dhe miratimin e një plani veprimi përmirësues. Rezultatet e shqyrtimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra për të korrigjuar çdo gjetje,

⁴⁰ Ndryshuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴¹ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴² Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴³ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴⁴ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴⁵ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

dokumentohen, nëpërmjet raporteve me shkrim ose procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit drejtues, apo të komiteteve përkatëse.

25. Bankat publikojnë në raportin e tyre vjetor, politikat e shpërblimit, shumat vjetore të agreguara të pagesave dhe shpërblimeve për këshillin drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë, si dhe format e shpërblimit të tyre, duke shpjeguar dhe argumentuar përputhshmërinë e këtyre pagesave me politikat e administrimit të rrezikut, profilin e rrezikut, të përcaktuar sipas objektivave afatgjatë të bankës, si dhe parimeve të përcaktuara në këtë nen.

KREU IV

Kriteret për kualifikimet, përvojën dhe kërkesat për dokumentacionin e miratimit të administratorëve

Neni 16

Kriteret për kualifikimet dhe përvojën

1. Administrator i bankës mund të jetë individ i me reputacion të lartë etik dhe profesional, me kualifikim dhe përvojë profesionale në drejtim.

1/1. ⁴⁶Administratori i bankës gëzon reputacion të lartë etik, nëse:

- a) nuk është në ndjekje penale, në gjykim për vepra penale dhe i dënua penalisht;
- b) ka vepruar me kompetencë në ushtrimin e funksioneve dhe në përshtatje me natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e veprimtarisë së bankës (nëse është e aplikueshme);
- c) ka treguar korrektësi në drejtim dhe, në veçanti, transparencë dhe bashkëpunim në marrëdhëniet me autoritetin mbikëqyrës dhe në qëndrimin ndaj masave mbikëqyrëse dhe ndëshkimore të tij (autoritetit mbikëqyrës);
- d) ka arritur rezultate të larta dhe ka shfaqur integritet profesional gjatë ushtrimit të funksioneve apo eksperiencave të mëparshme;
- e) nuk ka të dhëna mbi gjendjen financiare, të cilat mund të cenojnë reputacionin e tij, ose të dhëna të tjera, të cilat krijojnë dyshime të arsyeshme mbi reputacionin e këtij individ; si dhe
- f) ndaj tij nuk janë marrë masa disiplinore të largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit/vlerësimit, përveç rasteve kur masa disiplinore është konsideruar në kundërshtim me ligjin, me vendim gjykate të formës së prerë.

2. Kualifikimi dhe përvoja profesionale në drejtim duhet të jenë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e veprimtarisë së bankave, sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4 të këtij neni.

⁴⁶ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

3. Administratorët e propozuar zotërojnë kualifikim dhe përvojë profesionale të mjaftueshme dhe të përshtatshme, në rastet kur plotësojnë kriteret e mëposhtme:
- a. zotërojnë diplomë universitare ose minimalisht kanë kryer programin e ciklit të dytë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë (në rastin e administratorëve, shtetas shqiptarë) në ekonomi ose jurisprudencë, si dhe kanë përvojë (kanë punuar) të paktën 5 (pesë) vjet në një nga sektorët e mëposhtëm:
 - i) sistemi bankar/financiar,
 - ii) administrimi i rrezikut në tregjet financiare,
 - iii) administrimi financiar,
 - iv) auditimi,
 - v) mbikëqyrja bankare/financiare,
 - vi) eksperiencia ligjore ose akademike e lidhur me tregjet financiare; ose
 - b. zotërojnë diplomë universitare në një fushë tjetër të ndryshme nga ajo e shkencave ekonomike ose të jurisprudencës, dhe kanë përvojë në sektorin bankar, të paktën 5 vjet.
4. Administratorët e propozuar për pozicionin e anëtarit të këshillit drejtues ose të drejtorisë, përveç kriterëve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, do të konsiderohet se zotërojnë përvojë drejtimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në rastet kur plotësojnë edhe të paktën një nga kriteret e mëposhtme:
- a. kanë mbajtur një pozicion drejtues për të paktën 3 (tre) vjet në institucione financiare që veprojnë në tregun financiar të brendshëm ose të jashtëm;
 - b. kanë mbajtur një pozicion drejtues për të paktën 3 (tre) vjet në një autoritet mbikëqyrës të tregut bankar/financiar në Shqipëri ose në një shtet tjetër;
 - c. kanë mbajtur një pozicion drejtues për të paktën 5 (pesë) vjet në persona juridikë të ndryshëm nga ata të përmendur në shkronjat “a” dhe “b” të këtij paragrafi.
 - d. ⁴⁷kanë mbajtur pozicionet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni, (në vite të mbledhura) për të paktën 5 (pesë) vjet .
- ⁴⁸Kriteri i përvojës në drejtim, i parashikuar në këtë pikë, zbatohet për administratorët e propozuar në pozicionet: anëtar i Drejtorisë (Drejtor i Përgjithshëm, Zv. Drejtor i Përgjithshëm), anëtar i Këshillit Drejtues, anëtar i Komitetit të Kontrollit. Ky kriter nuk zbatohet për drejtuesit ekzekutivë që janë përgjegjës për funksionet e parashikuara në nenin 16, pika 5, shkronja “c”.
5. Në kategorinë e administratorëve - anëtarë të drejtorisë dhe drejtues ekzekutivë -përfshihen, por pa u kufizuar:

⁴⁷ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴⁸ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- a) drejtori i përgjithshëm;
- b) zëvendësdrejtori/ët i përgjithshëm; si dhe
- c) drejtorët ekzekutivë që janë përgjegjës për funksionet e mëposhtme:
 - i) origjinimi (shitja) e kredisë,
 - ii) investimet dhe tregtimi i instrumenteve për llogari të bankës,
 - iii) vlerësimi dhe kontrolli i agreguar i rreziqeve,
 - iv) sigurimi i përputhshmërisë,
 - v) parandalimi i pastrimit të parave,
 - vi) menaxhimi i operacioneve,
 - vii) mbikëqyrja e rrjetit të degëve,
 - viii) planifikimi, buxheti, ndjekja dhe raportimi financiar,
 - ix) kontrolli financiar,
 - x) menaxhimi i sistemeve elektronike të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

6. Në varësi të natyrës, madhësisë dhe kompleksitetit të bankës, një drejtues ekzekutiv mund të jetë përgjegjës për më tepër se një nga funksionet e mësipërme. Banka, në rastet kur përgjegjësia për ndonjë nga funksionet e mësipërme është e shpërndarë tek disa drejtues, përcakton drejtuesin që ka përgjegjësinë kryesore për këtë funksion.

Neni 17

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për miratimin e administratorëve

1. Banka paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë për marrjen e miratimit paraprak për administratorin përkatës, të shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në përputhje me pikën 2 ose 3 të këtij neni,⁴⁹ brenda 30 ditëve pune nga data e marrjes së vendimit të organit vendimmarrës.
2. Dokumentet e mëposhtme, të shoqëruara me formularët e plotësuar sipas anekseve të kësaj rregulloreje, i bashkëngjiten kërkesës:
 - a. vendimi i organit kompetent mbi propozimin për emërimin e administratorit përkatës;
 - b. dokumenti i identifikimit;
 - c. diploma e arsimit të lartë;
 - d. dokumentet, që vërtetojnë kualifikime të tjera të administratorit të propozuar;
 - e. të dhëna të detajuara për veprimtarinë tregtare dhe për bizneset e tij për 5 (pesë) vitet e fundit, duke përfshirë dhe informacionin për pjesëmarrjet influencuese;
 - f. të paktën një rekomandim lidhur me aftësinë profesionale, të lëshuar nga eprorë, punëdhënës të mëparshëm apo akademikë;
 - g. një përshkrim të detajuar të punës për pozicionin që do të mbajë administratori i propozuar;
 - h. deklaratë personale në lidhje me shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore;

⁴⁹ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- i. deklaratata personale e administratorit të propozuar, se gjatë punësimit të mëparshëm nuk ka kryer veprimtari sipas përcaktimeve në nenin 41 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, e plotësuar sipas formularit të aneksit nr. 2 të kësaj rregulloreje;
- j. për administratorët e propozuar si anëtarë të këshillit drejtues, deklaratë personale për interesat privatë, sipas përcaktimeve të nenit 44 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” (sipas aneksit 3 të kësaj rregulloreje);
- k. vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente, që certifikojnë se:
 - i) personi nuk është në ndjekje penale,
 - ii) personi nuk është në gjykim për vepra penale,
 - iii) personi nuk është i dënuar penalisht (nga Ministria e Drejtësisë),
 - iv) personi nuk ka detyrime pasurore të pashlyera (nga Zyra/t e Përmbarrimit Gjyqësor);
- l. ⁵⁰vërtetimi ose raporti i kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent i lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj.
- m. ⁵¹deklaratën, e cila përmban informacion për marrëdhënie pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit të Aneksit nr. 5 të kësaj rregulloreje).

Dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Banka, në rastin kur individi i propozuar për administrator është një shtetas i huaj, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, në rast se është e aplikueshme, paraqet në Bankën e Shqipërisë dhe lejen e tij të qëndrimit dhe të punës, në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.
4. Për administratorin shtetas i huaj, në rast se është e aplikueshme, vërtetimet e parashikuara në shkronjën “k” të pikës 2 të këtij neni do të paraqiten të lëshuara dhe nga organet kompetente të vendit të tij,
5. Dokumentacioni i përcaktuar sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të notuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse të shteteve të huaja, ai legalizohet nga autoritetet përgjegjëse.
6. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 18

Miratimi i administratorëve

⁵⁰ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁵¹ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

1. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për emërimin e administratorit të propozuar pasi vlerëson reputacionin dhe kualifikimet mbi bazën e:
 - a. dokumenteve të paraqitura në përputhje me pikën 2 të nenit 17, të kësaj rregulloreje;
 - a/1. ⁵²një analize të përgatitur nga banka që propozon administratorin, mbi përshtatshmërinë e njohurive profesionale të tij (administratorit), lidhur me pozicionin për të cilin propozohet, e cila bazohet kryesisht në:
 - i) ⁵³kohëzgjatjen, natyrën dhe kompleksitetin e eksperiencave të mëparshme të administratorit të propozuar duke përfshirë pozicionimin e tij në strukturën organizative të biznesit;
 - ii) kompetencat, vendimmarrjet dhe përgjegjësitë e ushtruara në pozicionet e mëparshme të punës;
 - iii) ⁵⁴njohuritë e përfituara nga këto pozicione pune, mbi institucionet financiare dhe administrimin e rreziqeve (evidentimin, vlerësimin, monitorimin, kontrollin dhe zbutjen e llojeve të rreziqeve kryesore) që përballen këto institucione;
 - iv) numrin e punonjësve që ka pasur në varësi;
 - v) argumentet dhe arsyet e përshtatshmërisë së administratorit të propozuar, me veprimtarinë, funksionet dhe detyrat që do të kryejë; si dhe
 - vi) vlerësimin e bankës mbi rezultatet e arritura dhe integritetin profesional të shfaqur, gjatë ushtrimit të funksioneve apo eksperiencave të mëparshme;
 - a/2. ⁵⁵një vlerësimi të përgatitur nga banka, mbi kohën e nevojshme në dispozicion, që administratori i propozuar do t'i dedikojë përmbushjes së funksionit dhe përgjegjësisë të tij, i cili (vlerësimi) duhet të bazohet kryesisht në angazhimin e tij si rrjedhojë e numrit të pozicioneve që ai mund të mbajë edhe në struktura të tjera drejtuese të filialeve të të njëjtit grup bankar apo në subjekte ku banka zotëron pjesëmarrje të rëndësishme;
 - b. dokumenteve ose informacioneve të tjera që zotëron Banka e Shqipërisë;
 - c. gjetjeve (konkluzioneve, përfundimeve) të vetë Bankës së Shqipërisë;
 - d. kur çmohet e nevojshme, dhe mbi bazën e një interviste të zhvilluar nga Banka e Shqipërisë me administratorin e propozuar.
2. Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit lidhur me dhënien e miratimit paraprak për emërimin e administratorit shtetas të huaj do të kryhet në dy faza, si më poshtë:
 - a. Në fazën e parë, Banka e Shqipërisë shpreh moskundërshtimin e saj për emërimin e administratorit shtetas të huaj kur, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 17 të kësaj rregulloreje, krijon bindjen se përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 16 të saj.

⁵² Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁵³ Ndryshuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁵⁴ Ndryshuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁵⁵ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- b. Në fazën e dytë, Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për emërimin e administratorit shtetas të huaj, pas plotësimit të dokumentacionit në përputhje me pikën 3 të nenit 17, të kësaj rregulloreje.
3. Banka e Shqipërisë refuzon miratimin paraprak për emërimin e administratorit të propozuar, kur mbi bazën e vlerësimeve të saj rezulton se administratori i propozuar nuk plotëson kushtet dhe kriteret e vendosura në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në këtë rregullore.
4. Në rastin e refuzimit të kërkesës për miratimin paraprak për emërimin e administratorit të propozuar, Banka e Shqipërisë jep me shkrim arsyet e këtij refuzimi.
5. ⁵⁶ Në rast se administratori mban disa pozicione në struktura të tjera drejtuese të filialeve të të njëjtit grup bankar apo në subjekte ku banka zotëron pjesëmarrje influencuese, Banka e Shqipërisë i kërkon bankës që administratori të lirohet nga një ose disa funksione, të cilat pengojnë punën e administratorit me kohë të plotë.
6. ⁵⁷ Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për miratimin e administratorit, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për miratim, nuk plotësohen nga banka brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për marrjen e miratimit. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratim, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim bankën.

Neni 19

Miratimi në rastet e ndryshimit të pozicionit të administratorëve ose riemërimit të tyre⁵⁸

1. Bankat, për çdo ⁵⁹emërim të administratorëve në një pozicion të ndryshëm nga ai ekzistues, por që vazhdon të ruajë cilësinë e administratorit në kuptim të pikës 19 të nenit 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, paraqesin në Bankën e Shqipërisë një kërkesë me shkrim për miratimin e këtij ⁶⁰emërimi. Kjo kërkesë shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
- a. dokumentin e emërimit sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 17 të kësaj rregulloreje;
 - b. CV-në e plotësuar sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
 - c. një përshkrim i detajuar i punës për pozicionin e ri që do të mbajë administratori i propozuar.

⁵⁶ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁵⁷ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁵⁸ Ndryshuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁵⁹ Ndryshuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁶⁰ Ndryshuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- 1/1. ⁶¹Banka, në rastet e riemërimit të administratorit në të njëjtin pozicion, paraqet në Bankën e Shqipërisë një kërkesë me shkrim për miratimin e këtij riemërimi. Kjo kërkesë shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) dokumentin e riemërimit, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 17 të kësaj rregulloreje;
 - b) CV-në e përditësuar, të plotësuar sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
 - c) një informacion/relacion të detajuar për vlerësimin dhe kontributin e administratorit, në drejtimin efektiv të bankës (për shembull një vlerësim të performancës së drejtuesit ekzekutiv, të kontributit të anëtarit të këshillit drejtues në mbledhjet e këtij organi, etj.);
 - d) informacione të tjera shtesë, të cilat mund të gjykohen të nevojshme.
2. ⁶²Banka e Shqipërisë mund të refuzojë dhënien e miratimit paraprak për emërimin e administratorit në një pozicion të ndryshëm nga ai ekzistues dhe/ose për riemërimin e tij, kur mbi bazën e vlerësimeve të saj, çmon se kualifikimet dhe përvoja e tij nuk janë të përshtatshme me pozicionin e propozuar si administrator apo kontributi i tij nuk vlerësohet i konsiderueshëm.

⁶³Neni 19/1

Procesi i rivlerësimit të administratorëve

1. Bankat kryejnë rivlerësimin e përshtatshmërisë së administratorëve të miratuar gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të paktën një herë në vit, si dhe në rastet kur gjykohet e nevojshme, bazuar në rrethana apo fakte të veçanta.
2. ⁶⁴ Bankat, nëpërmjet procesit të rivlerësimit të përshtatshmërisë së administratorëve të miratuar, sigurojnë plotësueshmërinë në vazhdimësi të kritereve të përcaktuara në këtë rregullore, si dhe raportojnë në Bankën e Shqipërisë rezultatet e procesit të rivlerësimit, mbi baza vjetore, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.
3. Bankat dokumentojnë procesin e rivlerësimit të përshtatshmërisë për të gjitha kategoritë e administratorëve, respektivisht, të anëtarëve të këshillit drejtues, anëtarëve të komitetit të kontrollit dhe të drejtuesve ekzekutivë.
4. ⁶⁵Bankat parashikojnë detyrimin për të gjithë administratorët, të cilët duhet të njoftojnë bankën për çdo rrethanë apo fakt që ka ndikim të rëndësishëm në përshtatshmërinë e tyre, për të realizuar funksionet, për të cilët ata janë miratuar ose të konfirmojnë, të paktën një herë në vit, që nuk kanë ndryshuar të dhënat mbi të cilat është dhënë miratimi paraprak nga Banka e Shqipërisë. Në rastet kur bankat konstatojnë mosplotësimin e kushteve

⁶¹ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁶² Ndryshuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁶³ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁶⁴ Ndryshuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁶⁵ Ndryshuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

nga administratorët, për të cilët është dhënë miratimi paraprak, njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë, por jo më vonë se brenda 5 ditëve pune nga konstatimi.

5. ⁶⁶Banka e Shqipërisë, pas njoftimit sipas pikës 4 të këtij neni, por edhe nëse e konstaton këtë fakt gjatë ushtrimit të procesit të saj mbikëqyrës, vlerëson nëse mund të zbatojë nenin 43 të ligjit për bankat.

Neni 20

Largimi i administratorëve

Bankat njoftojnë Bankën e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve për largimin e administratorëve të tyre, duke dhënë me shkrim arsyet përkatëse.

KREU V

Marrëveshjet me të tretët për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi për administrimin dhe drejtimin e bankës

Neni 21

Kriteret në përfundimin e marrëveshjeve me të tretët

1. Banka, me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, mund të përfundojë me të tretët marrëveshje për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi për administrimin dhe drejtimin e saj.
2. Banka, për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi nga të tretët:
 - a. harton dhe miraton një politikë për ushtrimin dhe kontrollin në mënyrë të përshtatshme të funksioneve dhe përgjegjësi nga të tretët;
 - b. siguron që vijimësia e veprimtarisë të saj, cilësia e shërbimeve dhe reputacioni i saj, nuk çënohen apo komprometohen nga transferimi i këtyre funksioneve dhe përgjegjësi;
 - c. siguron që ofruesi i shërbimit ka reputacionin dhe eksperiencën e duhur, si dhe një situatë financiare të qëndrueshme;
 - d. siguron që sistemi i kontrollit të brendshëm të përfshijë edhe funksionet dhe përgjegjësitë e deleguara të tretëve;
 - e. përcakton kriteret dhe harton metodat dhe procedurën për të ndjekur administrimin e rrezikut që rrjedh nga transferimi i funksioneve apo përgjegjësi;
 - f. sigurohet që ofruesi i shërbimit do të ruajë konfidencialitetin/sekretin e informacionit profesional të bankës dhe të klientëve, ndaj rrezikut të njohjes prej personave të paautorizuar;

⁶⁶ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- g. sigurohet që marrëveshjet me të tretët nuk e zvogëlojnë aftësinë e saj për të përmbushur detyrimet ndaj klientëve ose të pengojnë mbikëqyrjen efektive nga Banka e Shqipërisë.
3. Banka nuk mund të përfundojë me të tretët marrëveshje për të transferuar ushtrimin e funksionit të kontrollit të brendshëm dhe/ose për ushtrimin e veprimtarive bankare ose financiare të përcaktuara në nenin 54, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.
4. Banka, pa miratimin e Bankës së Shqipërisë, mund të kontraktojë dhe nënshkruajë marrëveshje me palë të treta për shërbimet e mëposhtme:
- a. telefoni;
 - b. shërbime të informacionit të tregut si Bloomberg, Moody’s, Standard & Poors etj.;
 - c. rrjetet e infrastrukturës së përbashkët si VISA, Mastercard etj.;
 - d. funksione të cilat ajo nuk mund t’i kryejë vetë si: shërbime këshilluese, opinione juridike, vlerësime të pavarura etj.;
 - e. të tilla që përgjithësisht konsiderohen me rrezik të ulët si: shërbimi postar, shtypshkrimet, blerje mallrash e pajisjesh etj.

Neni 22

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për marrjen e miratimit paraprak, për përfundimin e marrëveshjeve me të tretët

1. Banka, me qëllim marrjen e miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë për marrëveshjet që do të përfundojë me të tretët për transferimin e funksioneve dhe përgjegjësive për drejtimin e saj, paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
- a. projekt marrëveshjen e miratuar nga palët, e cila ndër të tjera përmban:
 - i. qëllimin e marrëveshjes,
 - ii. funksionet dhe përgjegjësitë që do të transferohen,
 - iii. marrëdhënien midis bankës dhe ofruesit të shërbimit (të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të palëve),
 - iv. kushtet dhe/ose procedurat për zgjidhjen e marrëveshjes,
 - v. mënyrën dhe periodicitetin e raportimit nga ofruesi i shërbimit për bankën, lidhur me mbarëvajtjen e realizimit të shërbimit etj.;
 - b. një vlerësim për pritshmërinë e zbatimit të marrëveshjes lidhur me:
 - i. efektet e kësaj marrëveshjeje në qëndrueshmërinë financiare, reputacionin dhe veprimtarinë e bankës,
 - ii. performancën e pritshme të ofruesit të shërbimit,
 - iii. kostot dhe përfitimet që do të rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes;
 - c. aktet e brendshme lidhur me mënyrën dhe procedurat e zhvillimit të funksioneve dhe përgjegjësive të transferuara;
 - d. planin e vazhdimësisë (vijimësisë) së veprimtarisë/ve;

- e. dokumentacionin me të dhënat identifikuese për ofruesin e shërbimeve, si më poshtë:
 - i. statutin e shoqërisë,
 - ii. certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si person juridik (për personat juridikë të huaj – aktet e barazvlefshme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj),
 - iii. ekstraktin e Regjistrimit Tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në të cilin të jetë përcaktuar dhe veprimtaria/të për të cilin/at është lidhur marrëveshja (për personat juridikë të huaj – aktet e barazvlefshme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj),
 - iv. për administratorët e propozuar, dokumentacionin e parashikuar sipas kërkesave të pikës 2 të nenit 17, të kësaj rregulloreje;
 - f. vërtetimin nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale të vitit të fundit financiar për ofruesin e shërbimit;
 - g. bilancin kontabël dhe pasqyrat financiare të ofruesit të shërbimit për vitin e fundit, të vërtetuara nga eksperti kontabël i autorizuar.
2. Dokumentacioni sipas pikës 1 të këtij neni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noteruar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse të shteteve të huaja, ai legalizohet nga autoritetet përgjegjëse.
 3. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.
 4. ⁶⁷Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për miratimin për të përfunduar me të tretët marrëveshje për transferimin e funksioneve dhe përgjegjësive për drejtimin e saj, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për miratim nuk plotësohen nga banka brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për marrjen e miratimit. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratim, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim bankën.

KREU VI

Dispozita të fundit

Neni 23

Të tjera

1. Bankat, si pjesë të raportit vjetor të tyre, publikojnë edhe një deklaratë gjithëpërfshirëse, koherente dhe përshkruese, mbi rregullat dhe procedurat kryesore që ato (bankat) zbatojnë, në lidhje me parimet bazë të drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv, në përputhje me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre, ⁶⁸si dhe në veçanti strukturën

⁶⁷ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁶⁸ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

organizative që siguron një ndarje të qartë të detyrave, përgjegjëse dhe raportimit, sipas modelit të tre linjave të kontrollit.

2. ⁶⁹Bankat, si pjesë të raportit vjetor të tyre, publikojnë një deklaratë të veçantë për oreksin/tolerancën ndaj rrezikut të ndërmarrë, në përmbushje të objektivave të tyre strategjike. Deklarata rishikohet nga këshilli drejtues mbi baza vjetore dhe në çdo rast që evidentohen ndryshime të rëndësishme (materiale) në veprimtarinë e tyre, të cilat mund të ndryshojnë qasjen/vendimmarrjen e këshillit drejtues për oreksin/tolerancën ndaj rrezikut.
3. ⁷⁰Bankat sigurojnë që deklarata e oreksit/tolerancës ndaj rrezikut, të adresojë çështjet e kulturës dhe oreksit/tolerancës ndaj rrezikut dhe kapaciteteve të rrezikut të bankës, gjatë ushtrimit të veprimtarive bankare e financiare.
4. ⁷¹Bankat, si pjesë e raportit vjetor të tyre, publikojnë edhe informacionin mbi periodicitetin e takimeve të Këshillit Drejtues dhe komiteteve të tij, si dhe informacionin mbi nivelin e pjesëmarrjes, zotërimet dhe nivelin e ndikimit në shoqëri të tjera.

Neni 24 Të fundit

⁷²Aneksi 1, 2, 3, 4 dhe 5 bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e kësaj të fundit.

⁷³Departamenti i Mbikëqyrjes publikon në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë udhëzuesin “Mbi drejtimin e brendshëm dhe efektiv të bankave”, të hartuar në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira për drejtimin efektiv të tyre.

**KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
ARDIAN FULLANI**

⁶⁹ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁷⁰ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁷¹ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁷² Ndryshuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁷³ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

**INFORMACION PËR KANDIDATIN PËR ADMINISTRATOR BANKE
(Informacioni i dhënë konsiderohet sekret nga Banka e Shqipërisë)**

1.	EMRI DHE SELIA E BANKËS	
2.	INFORMACION PERSONAL	
	Emri dhe Mbiemri	
	Adresa e banimit	
	Data dhe Vendi i Lindjes	
	Shtetësia	
	Numri i telefonit të punës	
	Numri i telefonit të shtëpisë	
	Adresa e e-mail-it	
3.	<p align="center"><u>KUALIFIKIMI ARSIMOR</u></p> <p><i>(lutemi listoni në mënyrë kronologjike të gjitha institucionet arsimore që keni ndjekur, kohëzgjatjen e pjesëmarrjes, datën e diplomimit dhe titujt akademikë)</i></p>	
4.	<p align="center">NIVELI I NJOHJES SË GJUHËVE TË HUAJA</p> <p><i>(lutemi listoni gjuhët dhe nivelin e njohjes së tyre)</i></p>	
5.	<p align="center">TRAINIME TË AVANCUARA</p> <p><i>(lutem listoni në mënyrë kronologjike të gjitha kurset, periudhat, temat e kursit, organizatorët)</i></p>	
6.	<p align="center">EKSPERIENCA NË PUNË</p> <p><i>(lutem listoni në mënyrë kronologjike të gjitha punësimet e mëparshme. Titullin e pozicionit dhe kohëzgjatjen e punësimit si dhe detyrat e kryera për secilën)</i></p>	
	<p>⁷⁴PJESËMARRJE NË KËSHILLA DREJTUESE/ NË SHOQATA PROFESIONISTËSH</p>	

⁷⁴ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

	<i>(lutemi listoni shoqëritë/shoqatat ku jeni ose keni qenë anëtar i këshillave drejtues, datat e pjesëmarrjes, etj.)</i>	
	⁷⁵ Emri dhe adresa e punëdhënësit	
	Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
	Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
	Përgjegjësitë (të detajuara)	
	Arsyet e largimit	a) Dorëheqje !__! b) Shkurtim i vendit të punës !__! c) Dalje në pension !__! d) Përfundimi i kontratës !__! e) Pushim nga puna !__! f) Të tjera !__! Specifiko
7.	EMRIN, POZICIONIN, ADRESËN E DY PERSONAVE NË SEKTORIN BANKAR APO FINANCIAR TË CILËT MUND TË SHPREHIN OPINIONET E TYRE LIDHUR ME KOMPETENCËN PROFESIONALE DHE INTEGRITETIN PERSONAL TË KANDIDATIT. <i>(nëse këta persona nuk mbajnë më pozicionet e referuara në rregullore specifiko kur dhe ku ata i kanë patur këto pozicione)</i>	1. 2.
8.	A keni ju ose persona të lidhur me ju, përcaktuar sipas ligjit për bankat, ndonjë marrëdhënie financiare me bankën (kredi, garanci etj.)? Nëse “po”, ju lutemi citojini ato.	
9.	A keni ju ose persona të lidhur me ju, përcaktuar sipas ligjit për bankat, pjesëmarrje ose ndonjë interes tjetër financiar me bankën? Nëse “po”, ju lutemi citojini ato.	
10.	A keni ju ose persona të lidhur me ju, përcaktuar sipas ligjit për bankat, pjesëmarrje aksionere ose ndonjë interes tjetër financiar me ndonjë bankë tjetër ose kompani? Nëse “po”, ju lutemi citojini ato.	

⁷⁵ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

11.	<p>A jeni drejtues ose anëtar i bordit drejtues, ose përfaqësues ligjor apo merrni pjesë në ndonjë mënyrë tjetër në krijimin dhe implementimin e politikave të biznesit në ndonjë bankë tjetër, subjekt financiar jobankë apo shoqëri kursim-krediti ose në ndonjë institucion tjetër financiar apo shoqëri tregtare?</p> <p>Nëse “po”, ju lutemi citojini ato.</p>	
12.	<p>A ka raste në pjesëmarrjet tuaja si drejtues i një banke, shoqërie tregtare apo institucioni financiar ku ju keni marrë pjesë në hartimin dhe implementimin e politikave të biznesit, ku të jeni ndeshur me vështirësi financiare që kanë rezultuar me fillimin e procedurave të riabilitimit apo falimentimit kundrejt këtyre shoqërive tregtareve apo institucioneve?</p> <p>Nëse “po”, lutemi listoni.</p>	
13.	<p>A keni qenë ndonjëherë i dënuar për kryerjen e një ose disa veprave kriminale referuar kërkesave të kësaj rregulloreje?</p> <p>Nëse jeni qytetar i huaj ose jetoni jashtë Republikës së Shqipërisë, a jeni dënuar jashtë për akte kriminale?</p> <p>Nëse “po”, lutemi listojini.</p>	
14.	<p>A ka ndodhur që banka apo institucione financiare në të cilat ju keni patur pozicion drejtues dhe keni qenë të përfshirë në hartimin dhe implementimin e politikave të biznesit, të ketë qenë subjekt i masave ndreqëse (ndëshkuese) ose t'i jetë revokuar licenca për të vepruar nga institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e bankave, shoqërive të sigurimit dhe institucioneve të tjera financiare të tregut?</p> <p>Nëse “po”, ju lutemi shpjegoni në mënyrë të plotë.</p>	
15.	<p>A ju është refuzuar apo revokuar ndonjëherë miratimi për mbajtjen e një pozicioni drejtues apo kryerjen e aktiviteteve në një fushë të caktuar operacionale?</p> <p>Nëse “po”, ju lutemi të shpjegoni në mënyrë të plotë.</p>	

16.	<p>Sipas opinionit tuaj, ekziston ndonjë fakt apo rrethanë tjetër që mund (të gjykohet i arsyeshëm) të konsiderohet i rëndësishëm për vlerësimin e përshtatjes tuaj për pozicionin e administratorit të bankës (për shembull fakte dhe rrethana që lidhen me kualifikimet tuaja profesionale, vështirësi financiare ose konflikt interesi)?</p> <p>Nëse “po”, ju lutemi listoni.</p>	
17.	<p>A është nisur ndonjëherë procedurë falimentimi kundrejt pronës tuaj?</p> <p>Nëse “po”, shpjegoni në mënyrë të plotë.</p>	

Unë deklaroj që të gjitha përgjigjet e mësipërme janë të vërteta dhe të plota. Ato janë dhënë bazuar në dijeninë time dhe unë nuk kam fshehur ndonjë informacion që mund të influencojë vendimin e Bankës së Shqipërisë.

Gjithashtu, unë do të informoj menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim të mundshëm që mund të ketë efekt në dhënien e miratimit për emërimin tim si administrator.

Vendi dhe data:

Firma e Kandidatit

Deklaratë

Në bazë dhe për zbatim të nenit 41 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", deklaroj me përgjegjësinë time të plotë si më poshtë vijon:

	Deklarata personale	Po	Jo
a)	është administrator i një shoqërie tjetër në Republikën e Shqipërisë, përveç rasteve kur kjo shoqëri është person i lidhur me të;		
b)	është aksioner i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i më shumë se 5 për qind të aksioneve me të drejtë vote, të një banke tjetër ose person i lidhur me të;		
c)	shërben ose ka shërbyer në çdo kohë gjatë periudhës 5 vjeçare paraardhëse si administrator i një banke, e cila ka qenë subjekt i procedurave të likuidimit të detyruar sipas dispozitave të këtij ligji;		
d)	shërben ose kanë shërbyer në çdo kohë gjatë periudhës 12 mujore paraardhëse, në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;		
e)	është punonjës i Bankës së Shqipërisë;		
f)	është në ndjekje penale ose është shpallur fajtor nga gjykata për një vepër penale për të cilin ligji parashikon dënimin me burgim;		
g)	ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese të detyrimeve dhe nuk është çliruar ende nga pagesa e detyrimeve të shkuara;		
h)	është ndëshkuar nga Banka e Shqipërisë gjatë 5 vjetëve të fundit për shkelje të rëndë të këtij ligji ose për zhvillim të veprimtarisë pa licencën përkatëse të lëshuar nga Banka e Shqipërisë;		
i)	është punonjës ose ortak i një shoqërie që është ekspert kontabël ose konsulent financiar i një banke ose i një dege të bankës së huaj që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë;		
j)	detyrimet e tij tejkalojnë pretendimet dhe investimet e tij në bankë ose është i lidhur me persona juridikë, detyrimet e të cilëve ndaj bankës tejkalojnë pretendimet dhe investimet e tyre në bankë;		
k)	është kreditor dhe njëkohësisht vlera e përgjithshme e kredive të tij ndaj bankës tejkalon një të katërtën e aktiveve të saj.		

Vendi dhe data:

Firma e Kandidatit

Deklaratë*

Në bazë dhe për zbatim të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, deklaroj me përgjegjësinë time të plotë si më poshtë vijon**:

		Bankën	Aksionerët që ushtrojnë kontroll mbi bankën	Drejtuesit ekzekutivë
a)	A keni interesa që burojnë nga marrëdhënie pasurore ose tregtare të drejtpërdrejta, ose të tërthorta të çdo lloj natyre, me:			
b)	A keni interesa që burojnë nga marrëdhënie të tjera juridiko – civile, me:			
c)	A keni marrë dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale që lidhen me:			
d)	A keni bërë negocime të mundshme për punësim, apo për çdo lloj forme tjetër marrëdhënieje me interes privat në të ardhmen, me			
e)	A jeni të angazhuar në veprimtari të tjera private me qëllim fitimi, ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura që lidhen me:			
f)	A keni ju interesa që burojnë nga marrëdhënie familjare, ose të bashkëjetesës me:	n.a.		

*Kjo deklaratë plotësohet vetëm nga administratorët e propozuar të bankës në pozicionin e anëtarit të këshillit drejtues.

**Lutem plotësoni përgjigjet me “po” ose “jo”.

Vendi dhe data:

Firma e Kandidatit

Përbërja e këshillit drejtues të bankës dhe interesat privatë të anëtarëve të tij, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 2* të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar**

(Ky formular plotësohet nga banka në momentin e aplikimit të një ose disa anëtarëve të këshillit drejtues, për të vlerësuar strukturën aktuale të këshillit drejtues të bankës)

Nr.	Emri i anëtarit të këshillit drejtues	Pozicioni aktual i punësimit të anëtarit të këshillit drejtues dhe emri i punëdhënësit	Marrëdhëniet e interesave private të anëtarit të këshillit drejtues me:			Afati i emërimit në këshillin drejtues të bankës (datë, muaj, vit - datë, muaj, vit)
			Bankën	Aksionarët që ushtrojnë kontroll mbi bankën	Drejtuesit ekzekutivë	
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						
6.						

*Interesat privatë të anëtarit të këshillit drejtues me bankën dhe/ose me aksionerin/ët që ushtron/jnë kontroll mbi bankën dhe/ose me drejtuesit ekzekutivë të bankës, të përcaktuara sipas nenit 44, pika 2 të ligjit për bankat janë:

- marrëdhënie pasurore ose tregtare të drejtpërdrejta ose të tërthorta të çdo lloji natyre,
- çdo marrëdhënie tjetër juridiko – civile,
- dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale,
- negociime të mundshme për punësim apo për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për administratorin në të ardhmen, pas lënies së detyrës si administrator, të kryera nga ai gjatë ushtrimit të detyrës si administrator në bankë,
- angazhime në veprimtari të tjera private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura,
- marrëdhënie familjare ose të bashkëjetesës.

**Lutemi plotësoni përgjigjet në kutiza me “po” ose “jo”. Në rast të plotësimit me “po” të jepen shpjegime për llojin e marrëdhënies së interesave private të anëtarit të këshillit drejtues sipas (*) më lart.

⁷⁶ Shtuar me vendimin nr.73, datë 6.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

DEKLARATË

Nëpërmjet së cilës unë vërtetoj se kam/nuk kam lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë.

Shënim: Në rastin kur administratori i propozuar deklaron se ka lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, rendit në vijim emrat e personave.

Nr.	Emri i personit të lidhur me administratorin e propozuar	Lloji i lidhjes (familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore), duke e specifikuar	Ka dënim penal të formës së prerë (sqaro llojin e dënimit)
1			
2			
3			
...			

Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë, Bankës së Shqipërisë.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë miratimin tim si administrator i Bankës _____, në kërkesë dhe në atë shkallë, që kjo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve pasqyron ndershmërinë dhe personalitetin tim, kjo mund të shërbejë si shkak për mohimin e krejt kërkesës.

Në qoftë se kërkohet informacion shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

(Emri/Mbiemri i administratorit të propozuar)

_____/_____/_____
(Data)

(nënshkrimi i plotë)

⁷⁷ Shtuar me vendimin nr.21, datë 6.4.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.